



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

K.Dh.Shk.II.nr.1421/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS– Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Crimson Financial Found LLC, me seli në Prishtinë, kundër debitorëve: 1. N.T.Sh. Krass, me seli në Prishtinë, rr. “Vëllezërit Fazliu” dhe 2. A.K., me adresë në rr. “Vëllezërit Fazliu”, me seli në Prishtinë, objekt përmbarimi pagesën e kredisë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.772/2022 të datës 26.09.2023, me datën 20.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit N.T.Sh. Krass, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.772/2022 të datës 26.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.772/2022 të datës 26.09.2023, në dispozitiv ka vendos që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit N.T.Sh. Krass, i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit numër P.nr.672/2021 të datës 22.07.2021, i lejuar nga Përmbaruesit Privat Bardh B. Tasholli, duke e ka lënë në fuqi urdhërin përmbarimit P.nr.672/2021 të datës 22.07.2021, i lejuar nga Përmbaruesit Privat Bardh B. Tasholli me seli në Ferizaj.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë kanë parashtruar debitori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, për shkak të konstatimit të

gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e debitorit në tersi si e bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i datës 26.09.2023 si dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në ankesë, duke propozuar që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar ankesa e debitorit dhe aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.772/2022 të datës 26.09.2023, të mbetet në fuqi.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Zyra Përmbaremore e përmbareuesit privat Bardh B. Tasholli me seli në Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përmbaremore me të cilin ka lejuar përmbaremin në bazë të Marrëveshjes mbi Pengun e datës shtojca 1/606 të datës 21.12.2016 e regjistruar sipas Certifikatës për regjistrimin e pengut R-20210615-380 të datës 15.06.2021, për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja për Kredinë nr. 00606 të datës 21.12.2016, mbi borxhin total prej 26,408.38 euro, me kamatë ligjore dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Kundër propozimit për përmbaremin, prapsim ka paraqitur debitori në afat të rregullt ligjor, me të cilin ka theksuar se debitori me anë të këtij prapësimi në tërësi e kundërshton urdhrin e përmbareuesit privat për arsye se nuk qëndroj asnjë nga arsyet që parashihen me LPP-në. Ka shtuar se në rastin konkret kreditori ka paraqitur dokumente të rrejshme dhe të pa vërteta pasi që debitorët nuk kanë obligime ndaj kreditorit.

Kreditorët brenda afat ligjore kanë paraqitur përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar pretendimet e debitorëve, dhe duke propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorëve si i pa bazuar.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit dhe përgjigje në prapësim të kreditorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.772/2022 të datës 26.09.2023, në dispozitiv, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit N.T.Sh. Krass, i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përbarimit numër P.nr.672/2021 të datës 22.07.2021, i lejuar nga Përbaruesit Privat Bardh B. Tasholli, duke e ka lënë në fuqi urdhërin përbarimit P.nr.672/2021 të datës 22.07.2021, i lejuar nga Përbaruesit Privat Bardh B. Tasholli me seli në Ferizaj.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përbarimore. Konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore të procedurës përbarimore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se urdhri për lejimin e përbarimit të përbaruesit privat bazohet në Marrëveshjes mbi Pengun e datës shtojca 1/606 të datës 21.12.2016 e regjistruar sipas Certifikatës për regjistrimin e pengut R-20210615-380 të datës 15.06.2021, për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja për Kredinë nr. 00606 të datës 21.12.2016, të cilat dokumente mbi hipotekën paraqesin titull ekzekutiv në mbështetje të nenit 21,22 par 1.7 dhe 27 të LPP-së, për të qenë të përbarueshëm dhe njëkohësisht të përshtatshëm për përbarim. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar dokumentet përbarimore marrëveshjeve për kredinë, respektivisht hipotekën, mbi në bazë të të cilave përbaruesi privat ka zbatuar përbarimin, të cilat dokumente përbaruese përbejnë bazë juridike për caktimin e përbarimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 22 par. 1.7 dhe 27 i LPP-së, për të qenë të përbarueshëm dhe njëkohësisht të përshtatshëm për përbarim.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë me rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të ankimuar, mori parasysht pretendimet ankimore të debitorit sa i përket asaj se i njëjti ka bërë pagesa në ndërkohe kreditorit, ndërsa shuma e

përgjithshme nuk i është zbritur fare, si dhe nuk janë kontaktuar fare se sa është obligimi i mbetur i debitorit ndaj kreditorit.

Lidhur me pretendimet ankimore se dokumenti përmbarese mbi bazën e të cilën është lejuar propozimi për lejimin e përmbarimit nuk vërteton faktin se kjo kontratë është vërtetuar te organi kompetente, Dhomat e Shkallës së Dytë një pretendim të tillë e refuzoj si të pa abzuar për shkak se kontrata për kredin me nr.nr.00606 datës 21.12.20216 si dhe kontrata e pengut për kolateralin e luajshëm/shtojca 1/606 datës 21.12. 2016 janë të vërtetuar tek noteri Vizhdane Kuçi, po ashtu pretendimet tjera ankimore se shuma e kredis nuk është 24.000.00 euro por është 13.000.00euro, nuk qëndrojnë ngase në kredin e lartëcekur cekët shumë prej 24.000.00euro, andaj asnjë pretendim ankimor nuk qëndron sepse debitori nuk i ka provuar pretendimet e tij me asnjë provë të vetme.

Duke e shqyrtuar aktvendimin e ankimuar në raport me të gjitha pretendimet ankimore, gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë gjejnë se të njëjtat janë të pa bazuara. Me nenin 71 të LPP-së, janë paraparë shkaqet të cilat prapësimin e paraqitur ndaj aktvendimit për lejimin e përmbarimit do ta bënin të bazuar, andaj duke pasur parasysh se në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga arsyet e parapara në nenet e lartcekura, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.shk.II.nr.1421/23, me datë 20.03.2024

Gjyqtarja
Franciska Zhitija Ymeri